

**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR  
PROCEDURËN E HAPUR TË THJESHTUAR  
MALLRA**

**“F.V pjesë këmbimi për makinat e shërbimit të ASHP-së”**

Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - **me afat  
12 muaj**

**Agjencia e Sherbimeve Publike 2023**

**Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi**



## NJOFTIME

### NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT (Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor nese aplikohet)

#### 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor;

Emri :

Adresa:

#### 1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktor:

Institucion qendror

☐

Njësi e autoriteteve vendore

☐

Institucioni i pavarur

☐

Të tjera

☐

#### 1.3 Kategoria e Autoritetit Kontraktor:

Autoritet kontraktor që prokuron për nevoja të  
veta

☐

I deleguar

☐

Organ Qendror blerës

☐

Të tjera

☐

#### 1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin:

Tel/faks \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

#### 1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

#### 1.6 Lloji i procedurës së prokurimit:

#### 1.7 Tipi i kontratës:

**1.8Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit Kontraktor**

*(në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare) :*

---

**1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër :**

**1.10Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:**

**1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:**

**1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:**

**1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti kontraktor:**\_\_\_\_\_

---

## NJOFTIMI I KONTRATËS (Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### Seksioni 1: Autoriteti Kontraktor

#### 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

|                                                         |                                                                                     |
|---------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:                                                   | Agjencia e Shërbimeve Publike                                                       |
| Adresa:                                                 | Lagjja "Shkumbini", Elbasan                                                         |
| Tel/Faks:                                               | (+355) 58 523312                                                                    |
| E-mail:                                                 | <a href="mailto:ashp@elbasani.gov.al">ashp@elbasani.gov.al</a>                      |
| Adresa e ueb-faqes:                                     |                                                                                     |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin:<br>(emri, e-mail) | Alba Lika<br><a href="mailto:alba.lik@elbasani.gov.al">alba.lik@elbasani.gov.al</a> |

#### 1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktor:

|                              |                          |
|------------------------------|--------------------------|
| Institucion qendror          | Institucioni i pavarur   |
| <input type="checkbox"/>     | <input type="checkbox"/> |
| Njësi e autoriteteve vendore | Të tjera                 |
| <b>X</b>                     | <input type="checkbox"/> |

#### 1.3 Kategoria e Autoritetit Kontraktor:

|                                                    |                          |
|----------------------------------------------------|--------------------------|
| Autoritet kontraktor që prokuron për nevoja tëveta | Organ Qendror blerës     |
| <b>X</b>                                           | <input type="checkbox"/> |
| I deleguar                                         | Të tjera                 |
| <input type="checkbox"/>                           | <input type="checkbox"/> |

#### 1.4.Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po ☐ Jo **X**

#### 1.5 Kontratëqë bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po ☐ Jo **X**

## 1.6 Kontratë e rezervuar :

Po ☐ Jo ☒

**Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “F.V pjesë këmbimi për makinat e sherbimit te ASHP-se”**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-56234-01-18-2023**

**2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) 34330000-9-Pjese kembimi automjete, furgone dhe makina transporti mallrash,**

## 2.3 Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

|                                     |                          |                          |                          |
|-------------------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| Blerje                              | Marrje<br>me qira        | Blerje me këste          | Një kombinim i këtyre    |
| <input checked="" type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

## 2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po ☒ Jo ☐

## 2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik ☒

Me disa Operatorë Ekonomikë ☐

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po ☒ Jo ☐

## 2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

Per arsye organizative levrimi i mallit nga operatore te ndryshem nuk eshte i favorshem.

## 2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:

**Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 1 (një) (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)**

**2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:**

|  |  |                                                                                                                                                                                  |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  | <p>Nuk do të ketë rihapje të konkursit.</p> <p>Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik me të suksesshëm, i cili do të ofrojë çmimin më të ulët.</p> |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

**2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër:** (këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)

**Agjencia e Sherbimeve Publike****2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **Monedha, pa TVSH : prej 1'661'800** (njemilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e njemije e teteqind) **lekë pa tvsh. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.**

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është: 1,154,300** (njemilion e njeqind e pesëdhjetë e katërmije e treqind ) **lekë pa t.v.sh.**

3. Burimi i financimit: Buxheti i Agjencise se Sherbimeve Publike

4. Kodi Output: 2109014

5. Tipi:

Investime ☐

Kodi: \_\_\_\_\_

Vlera: \_\_\_\_\_

Shërbime ☐

Kodi:602

Vlera:1'661'800

**2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:**

Kohëzgjatja në muaj ☐☐☐ ose ditë ☐☐☐

Ose

Fillon më ☐☐☐☐☐ mbaron më ☐☐☐☐☐

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

**Kohëzgjatja në muaj: 12 ose ditë:\_\_\_\_\_ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër**

Ose fillon më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ (d/m/v)

mbaron më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ (d/m/v)

**2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës : Magazina e Agjensise së Sherbimeve Publike.**

**2.13 Ndarja në Lote:**

**Po**

☐

**Jo**

**X**

Nëse po,

**2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve**

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

**2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:**

☐ një Lot,

☐ disa Lote,

☐ të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:**

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi \_\_\_\_\_

**2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:**

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

---

---

---

---

**2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):**

**Po**

☐

**Jo**

☐

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

**2.15 Pranohen variantet:**

|           |                          |           |          |
|-----------|--------------------------|-----------|----------|
| <b>Po</b> | <input type="checkbox"/> | <b>Jo</b> | <b>X</b> |
|-----------|--------------------------|-----------|----------|

**2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:**

|           |                          |           |          |
|-----------|--------------------------|-----------|----------|
| <b>Po</b> | <input type="checkbox"/> | <b>Jo</b> | <b>X</b> |
|-----------|--------------------------|-----------|----------|

**Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:**

*(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)*

---

**2.15.2 Autoriteti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:**

|           |                          |           |                          |
|-----------|--------------------------|-----------|--------------------------|
| <b>Po</b> | <input type="checkbox"/> | <b>Jo</b> | <input type="checkbox"/> |
|-----------|--------------------------|-----------|--------------------------|

**Shënime të tjera** (nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti kontraktor)

---

---

---

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë (për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera).

---

|           |                          |           |                          |
|-----------|--------------------------|-----------|--------------------------|
| <b>Po</b> | <input type="checkbox"/> | <b>Jo</b> | <input type="checkbox"/> |
|-----------|--------------------------|-----------|--------------------------|

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:**

---

**2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po

☐

Jo

☐

**2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit:**

Po

☐

Jo

☐

### **Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike**

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **33'236 (tridhjetë e tremije e dyqind e tridhjetë e gjashtë) leke.**

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 \_\_\_\_\_ ( shuma, monedha)

Loti 2 \_\_\_\_\_ ( shuma, monedha)

**3.1.2** Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor **405279562**(të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

**3.1.3** Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën evlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 dite (shprehur në ditë)**

### **Seksioni 4: Procedura**

**4.1 Lloji i procedurës:** Proedurë e hapur e thjeshtuar

**4.2. Është përdorur njoftimi paraprak :**

Po

☐

Jo

☒

Nëse Po, numri i referencës është \_\_\_\_\_

**4.3Procedurë e rishpallur:**

Po

☐

Jo

☒

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit:
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit:
- c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit: (shuma,monedha)

#### 4.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

##### A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ☐

Sipas rëndësisë:

çmimi ☐ pikët ☐

\_\_\_\_\_ ☐ pikët ☐

\_\_\_\_\_ ☐ pikët ☐

\_\_\_\_\_ ☐ pikët ☐

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

#### OSE

##### B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

**Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi** (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

#### 4.4 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 31/01/2023(d/m/v) ora 10:00

Vendi: Prokurim elektronik ne websitin zyrtar te Agjencise se Prokurimit Publik:  
<http://www.app.gov.al/>

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al/)

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

**4.5 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:****Shqip****X****Anglisht**☐**Seksioni 5: Informacione shtesë:****5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):****Po**☐**Jo****X***Nëse po***Monedha**

---

**Çmimi**

---

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme)**

---

---

**Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi      **19/01/2023**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrit]*

## **FTESE PËR OFERTË**

(shënoni emrin e Autoritetit Kontraktor) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për furnizimin e mallrave në vijim:

.....  
.....  
.....

(jepni një përshkrim të saktë të mallrave dhe sasisë konkrete të kërkuar:

**Vendi i dorëzimit të mallrave:** (jepni një përshkrim të shkurtër)

**Koha e dorëzimit/lëvrimit:** Mallrat duhet të dorëzohen brenda datës \_\_\_\_\_

**Ofertat duhet të paraqiten në:**

.....[jepni adresën e saktë]

**Afati i fundit për pranimin e ofertave:**

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

**Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese** \_\_\_\_\_

**Forma e komunikimit:**

Forma shkresore ☐

Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) ☐

**Njoftimi i shkurtuar i Kontratës**  
**(Për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, për publikim në**  
**Buletinin e Njoftimeve Publike)**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri Agjencia e Shërbimeve Publike

Adresa Lagjja "Shkumbini", Elbasan

Tel/Faks (+355) 58 523312

E-mail [ashp@elbasani.gov.al](mailto:ashp@elbasani.gov.al)

Ueb-faqe [www.elbasani.gov.al](http://www.elbasani.gov.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër”**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-56234-01-18-2023**

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “F.V pjesë këmbimi për makinat e shërbimit të ASHP-se”**

**5. Fondi limit: 1'661'800** (njemilion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e njëmijë e teteqind) **lekë pa tvsh.** Shumatorja e çmimeve për njësi është **1,154,300** (njemilion e njëqind e pesëdhjetë e katërmijë e treqind ) **lekë pa tvsh.**

**6.Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj**

**7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 31/01/2023 Ora: 10:00**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoritet Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I**

**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Mallra:

Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

\_\_\_\_\_

| Numri i kontratës | Titulli i kontratës | Përshkrimi i shkurtër i kontratës |
|-------------------|---------------------|-----------------------------------|
| 01                | _____               | _____                             |
| 02                | _____               | _____                             |
| 03                | _____               | _____                             |
| ...               | _____               | _____                             |

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

*(Formular për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Faks \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Ueb-faqe \_\_\_\_\_

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_

**3. Lloji i procedurës së prokurimit:** \_\_\_\_\_

**4. Lloji i kontratës /Marreveshjes Kuader:** \_\_\_\_\_

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:**\_\_\_\_\_

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** \_\_\_\_\_

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**\_\_\_\_\_

**8. Fondi limit:**\_\_\_\_\_

**9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:**\_\_\_\_\_

**Shënim:**

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

*(Formular për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË  
ZBATIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor:**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Faks \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Ueb-faqe \_\_\_\_\_

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_

**3. Lloji i procedurës së prokurimit:** \_\_\_\_\_

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuader:** \_\_\_\_\_

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:** \_\_\_\_\_

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** \_\_\_\_\_

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** \_\_\_\_\_

**8. Fondi limit:** \_\_\_\_\_

**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër:**

\_\_\_\_\_

**12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):** \_\_\_\_\_

**13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër :** \_\_\_\_\_

**Dhe afati i ri (nëse është rasti):** \_\_\_\_\_

**14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:**

Emri \_\_\_\_\_

NIPT: \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Kontaktet \_\_\_\_\_

**15. Data e nënshkrimit të modifikimit:** \_\_\_\_\_

**16. Burimi i financimit:** \_\_\_\_\_

**17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti**

**kontraktor** \_\_\_\_\_

---

\_\_\_\_\_

---

## DOKUMENTAT E TENDERIT

### Përmbajtja:

#### **Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit të Kontrates.

#### **Seksioni II: Shtojcat**

Seksioni II përfshin formularët, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor si, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, sasia dhe grafiku i levrimit.

#### **Seksioni III. Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

Seksioni III përmban kushtet e përgjithshme dhe të veçanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

#### **Seksioni IV. Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

---

## Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

### A. TË PËRGJITHSHME

|                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1. Objekti i prokurimit</b>                | <p>1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.</p> <p>2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>2. Operatorët Ekonomik të përshtatshëm</b> | <p>a) Operator Ekonomik është çdo person fizik ose juridik ose ent publik apo grup personash/entesh, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").</p> <p>Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):</p> <p>1.1. të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;</p> <p>1.2. BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.</p> <p>b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.</p> |
| <b>3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit</b>   | <p>Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.</p> <p>Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>4. Ndryshimi i Dokumenteve të</b>          | <p>1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |

**Tenderit**

shtojcë, me këto ndryshime.

2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë sc është bërë publikimi i Dokumentat ë Tenderit.
3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e Ofertave, autoriteti kontraktor mund të zgjasë afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e ofertave, autoriteti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e ofertave me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

**B. PËRGATITJA E OFERTAVE**

1. **Shpenzi met e ofertimit** Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij, dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.
2. **Gjuha e Ofertës** Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim
3. **Dokume ntet përbërëse të Ofertës** Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti kontraktor.
4. **Formula rët e tenderit dhe Listat Çmimeve** Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.  
  
Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.
5. **Ofertat Alternative** Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.
6. **Çmimet** 1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në në Formularin e Ofertës

do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit..

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasi të dhe çmimin e tyre.
3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

- |    |                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|----|-------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 7. | <b>Monedha</b>                                              | Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 8. | <b>Provuashmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik</b> | Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 9. | <b>Periudha e vlefshmërisë së Ofertës</b>                   | <ol style="list-style-type: none"><li>1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.</li><li>2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërin nga format e mëposhtme:<ol style="list-style-type: none"><li>a) PAGESA nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit kontraktor</li><li>b) Garanci bankare</li><li>c) Garanci sigurimi</li></ol></li></ol> <p>Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.</p> |

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor e refuzon Ofertën.

Nëse autoriteti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

**10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave**

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

**D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE**

**11. Paraqitja e Ofertave**

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për Furnizimin e Mallrave; Njoftimi Nr. \_\_\_\_.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ----- d/m/v, në orën-----” .**

**12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nëse autoriteti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është

e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar.

Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

- |                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>13. Ofertat me vonesë</b>                      | Autoriteti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>14. Tërheqja , Zëvendësimi dhe Modifikimet</b> | <p>1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimi të ofertave.</p> <p>2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".</p> <p>3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.</p> |
| <b>15. Hapja e Ofertave</b>                       | Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |

#### **E. SHQYRTIMI I OFERTAVE**

- |                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>16. Konfidencialiteti</b>  | Autoriteti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimevetënenit 16 të LPP-së.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>17. Sqarimi i ofertave</b> | <p>1. Autoriteti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.</p> |
